



Në bazë të dispozitave të nenit 12, paragrafi 12.2, shkronja **d** të Ligjit nr. 03/L - 040, për vetëqeverisje lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", nr. 28/15, qershor 2008), nenit 24, paragrafët 1, 2, dhe nenit 25, paragrafët 1, 2, dhe 6 të Ligjit nr. 06/L-092, për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", nr. 10/03, prill 2019), dhe të nenit 33.2, shkronja **a**, dhe nenit 34.1, shkronja **d**, të Statutit të Komunës së Prishtinës, 01. nr. 110-391, të dt. 25.02.2010, Kuvendi i Komunës së Prishtinës, në mbledhjen e mbajtur më 10.02.2021, merr këtë

### **V E N D I M**

- I. MIRATOHET** propozimi i Kryetarit të Komunës për këmbimin e pronës së paluajtshme komunale me pronën e paluajtshme në pronësi të Arben Hasanit.
- II.** Prona e paluajtshme komunale që do të jepet në këmbim, ka këto karakteristika: pjesë e parcelës kadastrale, nr. 01949-11, sipërfaqe prej 465m<sup>2</sup>, Certifikata e pronësisë, nr. P-71914059-01949-11, Zona kadastrale Prishtinë, me destinim ndërtim, sipas Planit rregullues "Prishtina e Re - Zona Perëndim", i miratuar me Vendimin, nr. 01. nr. 35-186850, dt. 02.10.2013, kurse prona e paluajtshme që merret nga ky këmbim, është parcela kadastrale, nr. 01862-0, sipërfaqe prej 772m<sup>2</sup>, Zona kadastrale Çagllavicë, Prishtinë, Certifikata e pronësisë, nr. P-71914075-01862-0, në pronësi të Arben Hasanit, me destinim rrugë, planifikuar sipas Planit rregullues "Prishtina e Re - Zona Perëndim", miratuar me Vendimin, nr. 01. nr. 35-186850, dt.02.10.2013.
- III.** Këmbimi i pronës së paluajtshme është bërë pasi që nuk ekzistojnë parcela të tjera komunale të përshtatshme për realizimin e Planit rregullues "Prishtina e Re - Zona Perëndim" në Prishtinë.
- IV.** Para shpalljes publike të vendimit, do të bëhet vlerësimi i kualifikuar i vlerës së tregut të pronës së paluajtshme të Komunës dhe vlerësimi i pronës private, ku do të përcaktohen sipërfaqet e sakta të këmbimit.
- V.** Mënyra dhe kushtet e këmbimit të pronës së paluajtshme do të përcaktohen me kontratë, e cila lidhet dhe nënshkruhet në mes të Kryetarit të Komunës dhe pronarit të parcelës kadastrale që do të këmbehet.
- VI.** Pronat e paluajtshme komunale që do të këmbehen, të përshkruara në pikën II të këtij vendimi, duhet të evidentohen në librat kadastralë të Komunës.
- VII.** Për zbatimin e këtij vendimi kujdesen: Kryetari i Komunës, Drejtoria e Pronës dhe Drejtoria e Kadastrit e Komunës së Prishtinës.
- VIII.** Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e Komunës.

## Arsyetim

Drejtoria e Urbanizmit me Vendimin për përcaktimin e kushteve ndërtimore, nr. 05, nr. 350/02-147909/19, dt. 09.07.2020, ka dhënë Pëlqimin për këmbimin e pjesës kadastrale nr. 1949-11, me sipërfaqe prej 465m<sup>2</sup>, ZK Prishtinë, në pronësi të Komunës së Prishtinës. Parcela nr. 1862-0, ZK Çagllavicë, Prishtinë, në pronësi të Arben Hasanit. Pjesa e parcelës nr.1949-11, me sipërfaqe prej 465m<sup>2</sup>, gjendet në kuadër të bllokut urban “F-1-1” dhe “F-1-2”, tërësia “F-1” të Planit rregullues “Prishtina e Re – Zona Perëndim” në Prishtinë dhe parcela nr. 1862-0, Zona kadastrale Çagllavicë, me destinim rrugë, planifikuar sipas Planit rregullues “Prishtina e Re – Zona Perëndim”.

Propozimi për inicimin e këmbimit të parcelës/ave të tokës me pronarët e cekur në pikën II, është bërë për shkak të realizimit të Planit rregullues “Prishtina e Re – Zona Perëndim“ në Prishtinë, Vendimin për caktimin e kushteve ndërtimore, nr. 05, nr. 350/02-147909/19, dt. 09.07.2020. Pjesa e parcelës me nr. 1949-11, Zona kadastrale Prishtinë, shtrihet në zonë të planifikuar për ndërtim të lartë, ndërsa parcela nr. 1862-0, Zona kadastrale Çagllavicë, Prishtinë, shtrihen në infrastrukturë publike - rrugë të planifikuar.

Procedura e këmbimit të pronës komunale me pronë private, është duke u zhvilluar në bazë të nenit 25 të Ligjit nr. 06/L-092, për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës”, nr. 10/03, prill 2019).

Andaj, duke u bazuar në dispozitat ligjore të përshkruar në pjesën hyrëse të këtij propozimi dhe në shkresat e lëndës, propozojmë që të bëhet këmbimi i pronës komunale me pronë private, siç është përshkruar në pikën II të dispozitivit të këtij propozimi.

Pjesë përbërëse të këtij vendimi janë:

- skica grafike,
- kopjet e planit dhe
- certifikatat e njësisë kadastrale.

**KUVENDI I KOMUNËS SË PRISHTINËS**  
01-463/01-27289/21, më 11.02.2021

**KRYESUESI I KUVENDIT**  
Agim Kuleta

